



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEQA" GJILAN
Fakulteti Ekonomik – Economics Faculty

Dekani: Prof.Asoc.Dr. Xhevat Sopi

Nr.Prot 139/2021

Datë: 10.05.2021

NJOFTIM për studentët e Programit Menaxhment

Bazuar në vendimin e mbledhjes së XXII të Senatit me nr. 01/878/ dt. 26.04.2021, për ndryshimin e numrit të kredive të Punimit të Diplomës së Programit Menaxhment, nga 10 ECTS në 6 ECTS, konform kërkesës nga ky vendim, Dekani i Fakultetit Ekonomik i njofton studentët e Programit Menaxhment me sa vijon:

1. Për të gjithë studentët e Programit Menaxhment nga afati i ardhshëm i diplomimit, Punimi i Diplomës do të llogaritet me 6 kredië
2. Për të plotësuar numrin e nevojshëm të kredive, studentët të cilët ndjekin apo përsërisin semestrin e gjashtë, nga ky vit akademik e tutje, do të duhet të japin dy provime nga lëndët zgjedhore për të plotësuar numrin e nevojshëm të kredive.

Zyra e IT, sa më parë që mundet nga dita e publikimit të këtij njoftimi, do t'i bëjë ndryshimet e nevojshme në SMU dhe do t'u mundësoj studentëve të këtij programi që të bëjnë edhe zgjedhjen e lëndës së dytë zgjedhore në SMU (ashtu siç janë njoftuar nga Dekani që në fillim të semestrit kur kërkesa ishte aprovuar në Këshillin e Fakultetit)

Për çfarëdo problemi që mund të del në lidhje me zbatimin e këtij vendimi të Senatit, studentët mund të drejtohen te Zyra e IT (nëse problemi është i natyrës teknike) apo në Dekanat te Prodekani.

Njoftim t'i dorëzohet:

1. Zyrës së IT
2. Të publikohet në web
3. Parlamentit Studentor për publikim
4. Arkivit

Dekani

Prof.Asoc.Dr. Xhevat Sopi


Adresa: Rr. Zija Shemsiu p.n., 60000 Gjilan, Republika e Kosovës
www.uni-gjilan.net, tel. +383 (0) 280390112